

ABSTRAKT

Posedimi dhe mbrojtja e tij në të drejtën romake me vështrim krahasues në të drejtën pozitive të Kosovës dhe Shqipërisë

Kandidate: Besjana Maliqi

Mentori: Prof.Asoc.Dr. Bedri Bahtiri

Ky punim përmbledh institutin e posedimit që ka origjinë shumë të lashtë dhe në fakt ajo rrjedh nga e drejta Romake dhe zhvillimin e këtij instituti në drejtë pozitive të Kosovës dhe Shqipërisë pasi që ka rëndësi shumë të veçantë për të drejtën civile, duke trajtuar përkufizimin e nocionit të posedimit, se posedimi a është fakt apo e drejtë, dallimi midis pronësisë dhe posedimit, elementet si dhe llojet e posedimit që parashihen në legjislacionin e Kosovës dhe Shqipërisë. Posedimi përbën një institut që paraqet vështirësi për dhënien e nocionit dhe koncepteve që e karakterizojnë atë. Posedimi përfshin një marrëdhënie juridike ndërmjet personit që posedonte dhe atij që i jep poseduesit të drejtën e posedimit, pikërisht për këtë arsye posedimi sjell edhe efekte juridike si fitimin e pronësisë së sendeve të luajtshme me anë të posedimit me mirëbesim, fitimin e pronësisë me parashkrim fitues (usucapio) dhe efektët lidhur me frutet dhe shpërblimet për shpenzimet që i bën poseduesi lidhur me sendin.

Nisur nga objekti i studimit dhe kërkimeve në punën e bërë për punimin e kësaj teme, kemi përdorur metodat më bashkëkohore të punës teorike, duke përdorur një literaturë të konsiderueshme dhe bashkëkohore, duke u shërbyer me ligjet dhe kodet e vendeve si dhe duke i krahasuar në mes vete lidhur me institutin e posedimit, metodat të cilat janë përdorur janë: *metoda hulumtuese, metoda historike, metoda përshkruese, metoda krahasuese dhe metoda e analizës së legjislacionit.*

Si fokus ky punim ka pasur edhe mbrojtjen e posedimit që ligji ja kushton atij në Kosovë dhe Shqipëri, me anë të vetëmbrojtjes dhe padive posedimore dhe procedurën në kontestet e pengim posedimit, duke shtjelluar procedurën urgjente që ka dhe karakteristikat e kësaj procedure.